



COVID-19

Reagimi digjital

Një rast studimor që ravijëzon reagimin e CARE
dhe organizatave partnere gjatë pandemisë COVID-19

*Një rast studimor që ravijëzon reagimin e CARE dhe organizatave partnere
gjatë pandemisë COVID-19*

REAGIMI DIGJITAL NDAJ COVID-19

Autorë:
Emilija Milenković
Jana Šarić

Nëntor 2020



Falënderimet

Autorët e këtij raporti dëshirojnë të falënderojnë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij rishikimi. Ne i falënderojmë dhe u jemi mirënjohës organizatave partnere të të rinjve që morën pjesë në konsultime, ofruan kontribut kritik për rishikimin dhe mbledhjen e të dhënave, dhe kontribuan në rekomandimet paraprahe.

Gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë individët e mëposhtëm për komentet e tyre kthyes kritike gjatë procesit të rishikimit. Në mënyrë të veçantë, u jemi mirënjohës: Eleni Nanaj nga Qendra Vepro për Shoqërinë ('Act for Society Center') (Tiranë); Milica Jovičić nga Perpetuum Mobile, Feđa Mehmedović nga Shoqata XY dhe Nedim Mičjević nga Youth Power (Bosnje dhe Hercegovinë); Kadri Gashi nga SIT, dhe Dorina Glllogjani nga YMCA (Prishtinë); Tamara Tokić nga Status M (Zagreb), Tijana Mihajlović nga OEC Synergy (Mitrovica e Kosovës), Tamara Urošević nga Qendra E8 (Beograd) dhe kolegët e CARE International - Marina Starčević Cviko, Zvezdana Batković dhe Saša Petković.

CARE International

CARE International ka mbi 25 vjet përvojë në zbatimin e programeve në Ballkan. Gjatë luftërave dhe konflikteve të viteve të '90-ta, CARE reagoi ndaj shkatërrimit, traumatizimit, zhvendosjes dhe urrejtjes ndëretnike me aktivitetet e saj masive humanitare dhe jetëshpëtuese në të gjithë Ballkanin. Që nga viti 2000, orientimi i CARE është zhvendosur në punën zhvillimore dhe qëllimi i saj në Ballkan sot është të sigurojë që të drejtat sociale, ekonomike dhe politike të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara të njihen dhe përmbushen, duke kontribuar në paqen e qëndrueshme në rajon. Strategjia e Programit të CARE bazohet në dy shtylla: a) përfshirja socio-ekonomike e pakicave të cënueshme dhe grupeve të tjera të marginalizuara duke kontribuar në kapacitete më të forta dhe duke krijuar mundësi më të mira për ta, duke u mundësuar atyre që të integrohen në shoqëri dhe të përmbushin të drejtat e tyre; b) barazia gjinore midis grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara duke promovuar vlerat dhe praktikën e barazisë gjinore, diversitetit dhe mosdhunës, forcimin e kapaciteteve të akterëve lokalë, kombëtarë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë sociale, si dhe krijimin e mundësive për inovacion, pjesëmarrje, të mësuarit, bashkëpunimin dhe avokimin. CARE ushqen partneritete me sektorin lokal të shoqërisë civile dhe qeveritë të përkushtuara për krijimin e ndryshimeve pozitive në shoqëri.



© 2020 CARE International Balkans

Ky publikim është mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Fondacioni Oak. Përmbajtja dhe gjetjet e këtij publikimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverive austriake dhe zvicerane, ose fondacionit Oak.

Përmbajtja

1. Rreth Inicativës së Burrave të Rinj	8
2. Historiku dhe Metodologjia	11
2.1. Si e ndryshoi pandemia COVID-19 jetën shoqërore, arsimore dhe përditshmërinë në Ballkan?	11
2.2. Si reagoi YMI ndaj sfidës COVID-19	12
2.3. Metodologjia	16
3. Reagimi digjital i YMI	18
3.1. Klubet 'Bonu Burrë'	18
3.2. Punëtoritë online	20
3.3. Podkast-et	22
3.4. Sfidat e mediave sociale, kuizet dhe gjëgjëzat	23
3.5. Ngjarjet online	24
3.6. Prodhimi i video materialeve për të angazhuar të rinjtë/rejat	26
3.7. Mbështetja psikologjike	26
3.8. Vlerësimi përmbyllës	28
3.9. Fushatat e Normave Sociale dhe COVID-19	29
4. Konkludimet dhe mësimet e nxjerra	33
Organizatrat partnere	35



Përmbledhje ekzekutive

Projekti Iniciativa e Burrave të Rinj (YMI) filloi në vitin 2006 dhe po zbatohet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi, Kosovë dhe Serbi nga CARE International Balkans dhe organizatat partnere lokale. Projekti është një vazhdim i përpjekjeve gjithëpërfshirëse dhe programatike të CARE për të parandaluar dhunën ndërpersonale dhe me bazë gjinore (DHBGJ), si dhe për të promovuar barazinë gjinore në rajon. YMI shënjestron të rinjtë për të shtuar njohuritë dhe ndërtuar qëndrimet e tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe mënyrat e shëndosha të jetesës, dhe për të zvogëluar të gjitha llojet e dhunës. YMI nisi me një hulumtim cilësor përmasash të vogla duke hulumtuar qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve, për t'u shëndërruar më pas me kalimin e viteve në një program gjithëpërfshirës me komponentë të ndryshëm që shënjestronin të rinjtë/rejat, prindërit, mësimshënësit/et, punonjësit arsimorë, studentët/et universitarë, gazetarët/et, dhe akterë të tjerë të rëndësishëm. Që nga fillimi, programi ka arritur drejtpërdrejt mbi 600,000 njerëz (kryesisht të rinj/reja) në mbi 130 komunitete përmes zbatimit të mijëra aktiviteteve të ndryshme të projektit.

Shpërthimi i vazhdueshëm i COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në aktivitetet e YMI, pasi që të gjitha vendet e shënjestruara të projektit ishin nën mbyllje totale gjatë periudhës mars-maj, dhe shumica aktualisht janë nën masa sigurie dhe parandalimi, të cilat përfshijnë orë policore të pjesshme, kufizime të vogla të lëvizjes dhe lirive të tjera qytetare, përfshirë tubimet dhe ngjarjet shoqërore dhe kulturore. Duke marrë parasysh që aktivitetet e projektit fokusohen kryesisht në punën me të rinjtë/rejat në komunitete dhe institucione arsimore në të gjithë rajonin, kriza e COVID-19 ka ndikuar konsiderueshëm në zbatimin e projektit.

Rasti studimor prezanton dhe dokumenton procesin e adaptimit të YMI-së ndaj pandemisë COVID-19 gjatë periudhës mars-korrik 2020, duke përshkruar procesin dhe duke dhënë rekomandime dhe mësimet për të ardhmen. Ky rast studimor shërben si një produkt unik i zhvilluar nga CARE dhe partnerët, dhe përfaqëson një kontribut dhe burim unik për organizatat e tjera që po kalojnë nëpër të njëjtin proces adaptimi.

Në vitin 2020, qasja e YMI-së demonstroi qëndrueshmërinë e vet ndaj krizës dhe aftësinë për t'u përshtatur me rrethanat specifike të grupeve të synuara. YMI është krijuar për të rinjtë/rejat, për t'iu përgjigjur nevojave të të rinjve/rejave, kudo që mund të jenë ata. Digjitalizimi i aktiviteteve ishte fokusi kryesor i të gjitha organizatave partnere, gjë që mund të shihet si një azhurnim i punës së mëparshme digjitale që rezultoi në sukses të madh dhe solli risi të jashtëzakonshme në YMI. Kjo përfshiu rregullimin e punëtorive, hulumtimin përmbyllës, fushatat e bazuara në shkollë dhe në komunitete dhe takimet e Klubit Bonu Burrë (KBB), si dhe prezantimin e podcast-eve, shfaqjeve të drejtpërdrejta të mediave sociale, kuize dhe sfida online dhe mbështetjen psikologjike. ***Në periudhën mars-korrik 2020, gjatë pandemisë COVID-19, partnerët zbatuan mbi 600 aktivitete me 68,525 pjesëmarrës/e të drejtpërdrejtë, nga të cilët 90% ishin të rinj/reja të moshës 15-30 vjeç.***



Rreth Iniciativës së Burrave të Rinj



1. Rreth Iniciativës së Burrave të Rinj

Projekti Iniciativa e Burrave të Rinj (YMI) filloi në vitin 2006 dhe po zbatohet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi, Kosovë dhe Serbi nga CARE International Balkans dhe organizatat partnere lokale. Projekti është një vazhdim i përpjekjeve gjithëpërfshirëse dhe programatike të CARE për të parandaluar dhunën ndërpersonale dhe me bazë gjinore (DhBGj) si dhe për të promovuar barazinë gjinore në rajon. YMI shënjestron të rinjtë/rejat për të shtuar njohuritë dhe ndërtuar qëndrimet e tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe mënyrat e shëndosha të jetesës, dhe për të zvogëluar të gjitha llojet e dhunës. YMI nisi me një hulumtim cilësor përmasash të vogla duke eksploruar qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve/rejave, për t'u shndërruar më pas me kalimin e viteve në një program gjithëpërfshirës me komponentë të ndryshëm që shënjestronin të rinjtë/rejat, prindërit, mësuesit/et, punonjësit arsimorë, studentët/et universitarë, gazetarët/et, dhe akterët të tjerë të rëndësishëm. Që nga fillimi, programi ka arritur drejtpërdrejt mbi 600,000 njerëz (kryesisht të rinj/reja) në mbi 130 komunitete përmes zbatimit të mijëra aktiviteteve të ndryshme të projektit.

Thelbi i ndërhyrjes së YMI-së¹ është një seri e punëtorive edukative në grup së bashku me një fushatë të normave shoqërore dhe krijimi i klubeve “Bonu Burrë” që janë pjesë e Doracakut të njohur në nivel rajonal ***Programi për të Rinjtë - Qasjet Inovative në Parandalimin e DhBGj dhe Promovimin e Jetesës së Shëndoshë për Burra të Rinj dhe Gra të Reja*** i cili ka qenë një sukses i dokumentuar në Ballkanin Perëndimor. Programi është i fokusuar në transformimin e mjedisit shkollor në një mjedis që mbështet dhe ushqen barazinë gjinore dhe promovon një kulturë pa dhunë. Programi Y bazohet në besimin se nëse nxënësit/et mësojnë të njohin normat e dëmshme gjinore dhe u ofrohen hapësira të sigurta për të vënë në pikëpyetje këto konstrukte, ka një gjasë më të madhe të përbrendësimit të ideve të reja në mbështetje të sjelljeve të shëndosha, të paanshme gjinore, dhe jo të dhunshme.

Klubet “Bonu Burrë” (KBB) janë krijuar si klube të nxënësve të shkollave të mesme të angazhuar në një mënyrë kreative në hartimin dhe zbatimin e fushatave të normave shoqërore që drejtohen nga të rinjtë. Anëtarët e KBB-ve mundësohen të ndërtojnë veten dhe të inkurajojnë të tjerët të jenë më të mirë, duke siguruar një zonë të sigurt për të rinjtë/rejat, ku nuk ka paragjykime, ku mendimet sfidohen dhe ku inkurajohet një dialog dhe mendim autokritik. Përveç kësaj, ata marrin pjesë në aktivitete motivuese të tilla si netët e filmave, shkuarja në teatër dhe koncerte, lojëra sportive, udhëtime dhe takime me të rinj të tjerë dhe shkëmbim përvojash me ta përmes llojeve të ndryshme të kampeve rinore dhe kampeve për liderët e rinj.

1 Për më shumë informacion në lidhje me Iniciativën e Burrave të Rinj, ju lutemi referojuni Broshura e programit ose <https://youngmeninitiative.net/sq/>

Klubet “Bonu Burrë” përfshijnë burra të rinj dhe gra të reja me qëllim krijimin e një jetese të shëndoshë për të gjithë ata. Sot, ka 34 KBB në më shumë se 30 qytete në Ballkan, duke mbledhur mbi 2,600 burra të rinj dhe gra të reja.

Një nga qëllimet më të rëndësishme të CARE dhe organizatave partnere është futja e Edukimit për Aftësi Jetësore bazuar në Programin Y në kurrikulën e edukimit formal të shkollave të mesme në të gjithë Ballkanin. Deri më tani, programi është zbatuar në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë (BeH), Kroaci, Mal të Zi, Kosovë, Serbi dhe ka marrë akreditimin zyrtar në Kroaci, Serbi dhe Kosovë nga ministrinë e arsimit. Më e rëndësishmja, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, ajo është bërë e detyrueshme në kantonet Herzegovinë-Neretva dhe Bosnje-Podrinje në Bosnje dhe Hercegovinë dhe kujdestarët e klasës janë të detyruar t’i kushtojnë një të katërtën e kohës së takimeve.

Që nga fillimi, YMI është implementuar nga CARE dhe organizatat partnere – OJQ-të e të rinjëve/ rejave nga rajoni. Me kalimin e viteve, partnerët e YMI janë bërë qendra burimore dhe palët më të rëndësishme të interesit në lidhje me tema të tilla si: angazhimi i burrave dhe djemve në parandalimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore. Partnerët kryesorë të CARE janë: Status M nga Zagrebi, Qendra E8 nga Beogradi, SMART Kolektiv nga Beogradi, Shoqata XY nga Sarajeva, Instituti Perpetuum Mobile nga Banja Luka, Youth Power nga Mostari, Klubi Edukativ Rinor Sinergjia nga Mitrovica e Veriut në Kosovë, SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime dhe YMCA nga Prishtina, dhe Qendra Vepro për Shoqërinë nga Tirana.

Gjatë gjashtë viteve të para, YMI u mbështet nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme. Në shtatë vitet e fundit, Iniciativa e Burrave të Rinj ka fituar mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillimit, Fondacionit Oak dhe Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim për dy prej projekteve të saj: Burrat dhe Djemtë si Partnerë në Promovimin e Barazisë Gjinore dhe Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm tek të rinjtë në Ballkanin Perëndimor i zbatuar në rajon, dhe Promovimi i Mënyrave të Shëndosha të Jetesës në mesin e të Rinjëve në Bosnje dhe Hercegovinë duke Sfiduar Stereotipet Gjinore, të zbatuara në B&H.





Historiku dhe metodologjia



2. Historiku dhe metodologjia

2.1. Si e ndryshoi pandemia COVID-19 jetën shoqërore, arsimore dhe përditshmërinë në Ballkan?

Rastet e para të COVID-19 u dokumentuan në mënyrë sporadike në vendet e rajonit nga mesi i shkurtit deri në fillim të marsit të vitit 2020. Në fazën fillestare të epidemisë rastet ishin, me sa duket, të kontrolluara mirë dhe shumica e vendeve futën masa të ndryshme epidemiologjike për të parandaluar përhapjen e virusit të ri tek popullata. Shumica e masave mbetën në fuqi deri në fund të qershorit dhe disa mbetën aktive deri në fund të korrikut. Qeveritë dhe zyrtarët shëndetësorë të vendeve kishin mënyrën e tyre vetanake të ballafaqimit me pandeminë - disa pjesë të Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Shqipërisë dhe Serbisë vendosën të ndiqnin strategjinë e mbylljes dhe të kufizonin lëvizjen e qytetarëve, pjesërisht ose plotësisht. Kosova, Serbia dhe Shqipëria vendosën orën policore, me një afat kohor të pjesshëm ose pa afat kohor të parashikuar për blerje në dyqanet e ushqimeve ose farmaci. Serbia përjetoi orën më të gjatë policore gjatë fundjavës së Pashkëve në Prill - nga e premtja deri të hënën në mëngjes, i gjithë vendi u vu në pauzë dhe njerëzit qëndruan në shtëpitë ose banesat e tyre.

Shkollat kaluan në mësimin në distancë dhe metodat e mësimdhënies online, të cilat nënkuptonin shkollimin në shtëpi, izolimin dhe ndarjen nga bashkëmoshatarët. Shtëpitë u bënë kënd lojrash, klube nate, klasa dhe vende të sigurta (ose jo aq të sigurta). Edhe pse mësimdhënësit/et dhe personeli shkollor u adaptuan me shpejtësi ndaj rrethanave të ndryshuara, stresi dhe frika e pasigurisë mbizotëroi në mesin e popullatës së të rinjve/rejave. Shëndeti mendor, mirëqenia emocionale dhe stabiliteti u bënë shqetësimet më të mëdha të punëtorëve rinorë dhe edukatorëve në të gjithë rajonin. ***Masat e izolimit dhe distancimit fizik u bënë realiteti i ri, së bashku me stresin dhe frikën e pasigurisë.***



Shkollimi në shtëpi gjithashtu ka sjellë me vete lloje të ndryshme të stresit, të panjohura më parë nga shumica e të rinjve - shumë nxënës/e të shkollave të mesme shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me sasinë e detyrave të shtëpisë, detyrat që u ishin caktuar dhe mungesën e kohës së lirë, thelbësore për mirëqenien e tyre emocionale dhe rritjen personale. Klima ngulfatëse shoqërore, liria e kufizuar e lëvizjes dhe shoqërimi i ndryshuar u bënë përditshmëria e re për shumicën e të rinjve/rejave në të gjithë rajonin. Sfidat më të mëdha për të gjithë të përfshirët në punën me të rinjtë/rejat ishte zvogëlimi i ankthit, shprehja e solidaritetit dhe të mësuarit për të qenë përkrahës pa praninë fizike. Kjo është edhe arsyeja pse u zhvilluan metodologji të ndryshme dhe u përdorën teknika të ndryshme për të kapërcyer këtë pengesë. Shpërthimi i COVID-19 ka zbuluar të metat dhe pikat e dobëta të shoqërive në nivel global, jo vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përveç sistemit shëndetësor, pjesë të tjera të shoqërisë u vunë gjithashtu para një sprove të qëndrueshmërisë, së bashku me sistemet arsimore në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Shqipëri dhe Kosovë. Edhe pse sistemet arsimore në vendet ku po zbatohet projekti Iniciativa e Burrave të Rinj janë të ndryshëm, para shpërthimit të COVID-19 ata kishin të paktën një gjë të përbashkët - mbështeteshin në metodologjinë tradicionale të mësimdhënies e cila ngadalë ndryshoi nën ndikimin e faktorëve

të ndryshëm. Përhapja e COVID-19 përshpejtoi procesin e kalimit në mësimdhënien online, shtyu personelin e shkollës dhe nxënësit/ettë përqafojnë qasje dhe teknika të reja e platforma online. Sistemet shkollore filluan transformimin e tyre drejt diçkaje që duket si një mënyrë më pjesmarrëse dhe më adekuate e mësimdhënies dhe mësimnxënies, e përshtatur enkas sipas gjeneratave, e cila lë hapësirë të mjaftueshme për përmirësime të mëtejshme, ndërhyrje dhe inkurajim.

Pavarësisht se ishin më fleksibile dhe e ndryshueshme lehtë, edhe OJQ-ve iu desh të rregullonin aktivitetet e tyre. Duke braktisur kontaktin ballë për ballë të përdorur në pjesën më të madhe të aktiviteteve, OJQ-ve iu desh të krijonin aktivitete të reja dhe të shqyrtonin të gjitha mundësitë e ofruara nga realiteti online, në mënyrë që të mbeteshin të pranishme, relevante dhe të dobishme për përfituesit e tyre. Mikromenaxhimi dhe koordinimi i projektit kishin kaluar në realitetin virtual dhe të dy, kolegët dhe përfituesit u bënë avatarë gjatë thirrjeve të gjata në Zoom ose Skype. I gjithë procesi i koordinimit të projektit u zhvendos nga zyrat në dhomat e ndenjes, duke fshirë kështu kufijtë midis punës dhe jetës private. Sfidë më e madhe ishte sigurimi i mbështetjes në kohë të vështira, duke mbetur të sigurt dhe produktiv, duke respektuar afatet, parametrat dhe treguesit e parashikuar nga propozimet e projektit. Brenda kornizës së projektit Iniciativa e Burrave të Rinj, koordinatorët, edukatorët bashkëmoshatarë dhe anëtarët e Klubeve 'Bonu Burrë' jo vetëm që arritën të rimodelojnë aktivitetet ekzistuese, por edhe të shpikin, dizajnojnë dhe implementojnë aso krejtësisht të reja, duke përdorur metodologjinë e njohur të Programit Y dhe qasjen e saj unike, të freskët dhe frymëzuese.

2.2. Si reagoi YMI ndaj sfidës COVID-19

Ishte planifikuar që YMI të arrijë kulmin e përpjekjeve të saj në Ballkan në vitin 2020. CARE dhe partnerët planifikuan **një proces shkallëzimi në nivel të gjithë rajonit** të zbatimit të **Programit Y** për të angazhuar më shumë se 100 shkolla, lansimin e një **fushate të re**, për parandalimin e radikalizimit



dhe ekstremizmit në të gjithë Ballkanin, dhe lansimin zyrtar të fushatës **lëvizja Future4Youth** me bazë në komunitet për futjen e Edukimit për Aftësitë Jetësore në kurrikulën zyrtare shkollore.

Sidoqoftë, pandemia COVID-19 ka sfiduar YMI-në në mënyra që ne nuk mund t'i kishim parashikuar.

Orët policore të pjesshme, kufizimet e vogla të lëvizjes dhe lirive të tjera qytetare, përfshirë tubimet dhe ngjarjet shoqërore dhe kulturore, prishën planet e rregullta të YMI-së. Duke marrë parasysh që aktivitetet e projektit fokusohen kryesisht në punën me rini në komunitete dhe institucione arsimore në të gjithë rajonin, kriza COVID-19 ka ndikuar ndjeshëm në zbatimin e projektit.


Që nga shpërthimi i COVID-19, CARE ka monitoruar nga afër situatën në të gjitha vendet dhe komunitetet ku po zbatohet projekti për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e stafit, programeve, organizatave partnere dhe përfituesve të CARE. CARE ka koordinuar procesin e planifikimit kontingjent në mars të vitit 2020, i cili përfshinte thirrjet emergjente në Skype dhe zhvillimin e planeve të nivelit të vendit dhe të rajonit dhe masave zbutëse. Qëllimi kryesor i kësaj ishte të bërit e mundur e një reagimi dhe përshtatjeje të shpejtë ndaj krizës së koronavirusit. Plani u bë në përputhje me rekomandimet e OBSH-së dhe CARE International dhe mori në konsideratë mirëqenien e të gjitha palësve të interesuara dhe përfituesve të përfshirë. CARE dhe partnerët kanë zhvilluar një plan kontingjence të COVID-19 për tre muajt e parë. Pas tre muajve fillestarë të bllokimeve të ashpra në të gjitha vendet, CARE dhe partnerët arritën të gjenin një modus operandi inovativ, të dizajnuar nga të rinjtë/rejat, efikas dhe efektiv, i cili rezultoi në progres të konsiderueshëm në secilën prej komponentëve të projektit, pavarësisht pandemisë COVID-19.

Digjitalizimi i aktiviteteve ishte fokusi kryesor i të gjitha organizatave partnere, i cili mund të shihet si një azhurnim i aktiviteteve të mëparshme digjitale. Të gjithë partnerët fituan shkathtësi të mjaftueshme digjitale, të praktikuara edhe para pandemisë, por ata bënë përpjekje shtesë në përshtatjen dhe dizajnimin e aktiviteteve online në mënyrë që të mbajnë hapin me përfituesit në baza ditore. Rezultati kryesor i procesit është që partnerët i përshtatën me sukses aktivitetet kryesore në terren ndaj një mjedisi online, duke arritur inovacion të jashtëzakonshëm dhe duke futur lloje të reja të aktiviteteve.



Në periudhën mars-korrik 2020, gjatë pandemisë COVID-19, partnerët zbatuan mbi 600 aktivitete me 68,525 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, nga të cilët 90% ishin të rinj/reja të moshës 15-30 vjeç.


Pjesëmarrësit në reagimin digjital ndaj COVID-19 të YMI në mars-korrik të vitit 2020



Mbështetje psikologjike	121	648	959	1097	1314
Kuize, sfida etj.	1015	1813	2769	3162	4813
Podcasts	906	2075	3760	4328	5353
Ngjarjet dhe takimet	695	931	7684	8519	12511
Punëtoritë e Programit Y	41	469	2418	2892	2991

Gjatë së njëjtës periudhë, YMI rriti praninë e saj online dhe zbatoi fushata të normave shoqërore për të zvogëluar stereotipet e dëmshme të lidhura me gjininë dhe kulturën e dhunës në mesin e adoleshentëve. Këto fushata u përshtatën ndaj situatës së pandemisë COVID-19 dhe ofruan një shumëllojshmëri këshillash mbi atë se si të ruajmë shëndetin fizik dhe mendor dhe si të mbrojmë veten gjatë pandemisë.

Angazhimi në fushatat e normave shoqërore të YMI-së gjatë karantinës së vitit 2020



YMI ka dëshmuar përsëri që qasja e saj është e përshtatshme dhe e adaptueshme ndaj kontekstit specifik të secilit grup të shënjestruar. YMI u krijua për të rinjtë/rejat, për t'iu përgjigjur nevojave të tyre, kudo që të ndodhen ata/o. Shpërthimi i vazhdueshëm i COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në aktivitetet e YMI, por nuk i ndërpreu aktivitetet e saj - përkundrazi, YMI fitoi më shumë hapësirë për t'u bërë inovative, për të rimenduar dhe përdorur zgjidhje të dizajnuara nga të rinjtë/rejat për të krijuar hapësira të sigurta për pjesëmarrësit tanë.



2.3. Metodologjia

Në zhvillimin e këtij rasti studimor, janë përdorur hulumtime ose metoda të kombinuara për mbledhjen e grupeve të të dhënave cilësore ose sasiore:

1. Rishikimi i literaturës (desk review) dhe analiza e dokumenteve: dokumentacioni i projektit, raportet mujore të partnerëve, planet kontingjente, lajmet dhe faqet zyrtare të internetit nga autoritetet kombëtare në lidhje me COVID-19 dhe politikat e vendeve përkatëse, përfshirë publikimet dhe mediat në dispozicion;
2. Të dhënat e pyetësorit në lidhje me adaptimin e partnerëve të YMI ndaj pandemisë COVID-19 (9);
3. Konsultimet online me të gjitha organizatat partnere bazuar në një intervistë gjysmë të strukturuar (10);
4. Analiza e historive (storjeve) të mbledhura nga pjesëmarrësit e programit bazuar në kontributet nga partnerët (deri në 10).

Për më tepër, të dhënat sasiore të mbledhura përmes tabelave mujore të monitorimit të reagimit të partnerëve të YMI-së ndaj COVID-19 mundësuan analiza gjithëpërfshirëse dhe zbatimin e metodologjisë së trekëndëshit për të përshkruar procesin e adaptimit të projektit ndaj pandemisë COVID-19.

Arsyet prapa zgjedhjes së metodave specifike për mbledhjen e të dhënave qëndrojnë në vetë natyrën e metodave: pyetësi është thelbësor që analistët të mbledhin të gjitha të dhënat e nevojshme për të fituar një pamj

3e të qartë të situatës, duke pasur parasysh që pandemia COVID-19 ndodhi papritur dhe partnerët duhej të përshtateshin me situatën dhe të rregullonin qasjet në baza mujore, madje edhe ditore.

Bazuar në të dhënat cilësore dhe sasiore, autorët zhvilluan konsultime online (bazuar në një intervistë gjysmë të strukturuar) me të gjithë partnerët e YMI për të mbledhur informacione të mëtejshme dhe për të parë marrëdhëniet reciproke dhe ngjashmëritë/dallimet në të kuptuarit e mjeteve të adaptimit dhe zbutjes. Për më tepër, janë mbledhur konsultime online me partnerë dhe histori nga pjesëmarrësit/et e programit për të.



Reagimi digjital i YMI





3. Reagimi digjital i YMI

3.1 Klubet ‘Bonu Burrë’

Një nga shtyllat më të rëndësishme të projektit YMI janë klubet “Bonu Burrë” në të gjithë rajonin. Në 13 vitet e zbatimit të projektit, KBB-të kanë qenë mekanizmi shtytës që ka drejtuar projektin, pasi anëtarët e tyre kanë qenë të angazhuar si edukatorë bashkëmoshatarë dhe model shembull për të rinjtë/rejat në vendet e tyre përkatëse.

Pandemia COVID-19 ia rikujtoi CARE dhe organizatave partnere potencialin e pamasë të klubeve ‘Bonu Burrë’ në rajon, të cilat arritën të mblidhnin në baza ditore dhe javore pothuajse 1,000 të rinj/reja për të marrë pjesë në aktivitetet e saj, dhe arritën të përshtateshin shpejt ndaj pandemisë COVID-19.

KBB-të ofrojnë një hapësirë të sigurt si offline ashtu edhe online për të rinjtë/rejat për të shprehur mendimet e tyre, për të gjetur qetësi dhe kënaqësi me bashkëmoshatarët e tyre dhe për të arritur potencialet e tyre, gjë që ka një rëndësi të madhe gjatë periudhës COVID-19.

Të gjitha KBB-të ofruan udhëzime, mbështetje psiko-sociale dhe mbështetje bashkëmoshatarësh në ballafaqimin me krizën. Një laramani aktivitetesh të ndryshme online u zhvilluan që nga marsi 2020, duke përfshirë zhvillimin e podcast-eve në Banja Llukë dhe Beograd, zhvillimin e shfaqjeve online, sesione të joga-s, përshtatjet inovative të fushatës së rregullt ndaj COVID-19, kuize online dhe lojëra për të rinjtë/rejat, si dhe seminare edukative online dhe stuhi mendimesh (brainstorming) për fushata të reja. Anëtarët e KBB-ve përfaqësojnë elementin kryesor në çështjet e ndërtimit të lëvizjes dhe ato të avokimit në lidhje me parandalimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore në këtë iniciativë.

Klubet “Bonu Burrë” (KBB) janë krijuar si klube të nxënësve të shkollës së mesme të angazhuara në një mënyrë kreative në hartimin dhe implementimin e fushatave të normave shoqërore dhe aktivitete të tjera të drejtuara nga të rinjtë/rejat. Anëtarët e KBB-ve u munësohet të përmirësojnë veten dhe të inkurajojnë të tjerët të jenë më të mirë, duke ofruar një zonë të sigurt për ta, ku nuk ka paragjykime, ku mendimet sfidohen dhe ku inkurajohet dialogu dhe mendimi autokritik. Përveç kësaj, ata marrin pjesë në aktivitete motivuese të tilla si netët e filmave, shkuarja në teatër dhe koncerte, lojëra sportive, udhëtime dhe takime me të rinj të tjerë dhe shkëmbim përvojash me ta përmes llojeve të ndryshme të kampeve rinore dhe kampeve për liderët e rinj.

**33**

Klubet 'Bonu Burrë'

**30**

qytete

**2600**

anëtarë

Tani për tani ka**33 KBB në 30 qytete****me mbi****2,600 anëtarë aktivë****që punojnë online dhe****në komunitetet e tyre.**

Pa to, projekti YMI nuk do të ishte i mundur.

Gjatë periudhës mars-korrik, u organizuan 100 takime online të anëtarëve të KBB-ve, të cilat shërbyen si bazë për të gjitha aktivitetet e YMI.

Reagimi humanitar i KBB-ve

Të qenit human dhe ndihmesa të tjerëve kur janë në telashe janë vlerat thelbësore të vullnetarëve dhe anëtarëve të KBB-ve që marrin pjesë në YMI. Në Mitrovicën e Veriut të Kosovës, 5 anëtarë të KBB morën pjesë në iniciativën për të ndihmuar të moshuarit në baza ditore, të organizuar nga partneri i YMI-së Sinergjia. Qëllimi ishte të shpërndahen ilaçe dhe ushqime për njerëzit e moshuar që kishin nevojë për ndihmë dhe ishin në rrezik të lartë të infektimit me COVID-19.

3.2. Punëtoritë online

Në mars të vitit 2020, partnerët mbajtën punëtoritë e tyre të fundit në klasa për vitin shkollor 2019/2020 për shkak të kufizimeve të COVID-19 të vendosura nga qeveritë në të gjitha vendet. CARE dhe të gjitha organizatat partnere filluan të bënin plane për të mbajtur punëtoritë e planifikuara nga Programi Y online, i cili ishte përfshirë në planet e tyre të kontingjencës të YMI. Ideja ishte të bërit përpjekje për të organizuar punëtori me 10-20 nxënës/e për grup nga shkollat e targetuara dhe dy edukatorë bashkëmoshatarë për të imituar një mjedis të rregullt shkollor.

Pas një muaji përgatitje teknike, sigurie dhe personeli dhe marrjes së lejes nga shkollat përkatëse dhe institucionet arsimore, tre organizata partnere - SIT dhe YMCA nga Kosova dhe AfS nga Shqipëria - arritën të organizojnë punëtori me të rinj në përputhje me planin e kontingjencës.

Në Kroaci, Status M arriti të mbledhë së bashku një grup të të rinjve/rejave rom për të vazhduar diskutimet mbi normat gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe mënyrat e shëndosha të jetesës bazuar në Programin Y. Hapësira e sigurt online që ata krijuan mbledhi bashkë të rinj nga pjesë të ndryshme të Kroacisë në momentet e izolimit, duke u dhënë atyre mundësinë të flasin reth ndjenjave, shqetësimeve dhe asaj nga çfarë kishin frikë dhe duke i ndihmuar ata të përballojnë me durim këtë situatë ngulfatëse. Gjatë secilit takim, edukatorët u lanë pjesëmarrësve kohë të mjaftueshme për të ndarë me të tjerët se si e kalojnë kohën në izolim, për të rekomanduar libra, seriale televizive dhe filma, për të kënduar dhe lozur, duke ndihmuar kështu njëri-tjetrin për të kaluar në kohën mënyrë konstruktive.

Grupi me të cilin Status M implementon punëtori kishte 6-10 pjesëmarrës/e, por me mundësinë e pjesëmarrjes në punëtori nga distanca, numri i pjesëmarrësve u rrit në 15. Punëtoritë mbahen një herë në javë në platformën Zoom me ndihmën e aplikacione të ndryshme për prezantim dhe ndërveprim online.

Në Serbi, Qendra E8 përgatiti punëtori, por administrata e shkollës nuk mori leje nga ministria për t'u dhënë atyre qasje te nxënësit gjatë mbylljes, kështu që Qendra E8 lansoi një thirrje për të gjithë të rinjtë që t'i bashkohen punëtorive nga Programi Y. Përgjigjja ishte më e madhe se sa pritej dhe 336 të rinj jo vetëm nga Beogradi, por nga i gjithë rajoni, morën pjesë në 24 punëtori nga Programi Y.

Si një alternativë ndaj punëtorive të Programit Y, partnerët në B&H dhe Mitrovicë Veriut në Kosovë organizuan punëtori të krijuara enkas për anëtarët e KBB për të diskutuar shëndetin mendor, të drejtat e njeriut dhe për t'i bërë ata më rezilientë ndaj pandemisë COVID-19.

Në Shqipëri, AfS arriti jo vetëm të zbatojë punëtoritë e Programit Y në shkollën e shënjestruar, por edhe të marrë leje për të rritur në shkallë zbatimin e Programit Y në rrethin e Krujës dhe mori mbështetje për përfshirjen e 8 shkollave shtesë në vitin shkollor 2020/2021, i cili është një sukses i madh. Gjatë periudhës prill-qershor, trajnerët e AfS dhe edukatorët bashkëmoshatarë punuan së bashku me mësimdhënësit/et dhe i ndihmuan ata të zhvillojnë orët e tyre duke organizuar punëtori dhe duke ndihmuar me nxënësit/et.



151

punëtori online



39%

Djemë të rinj



2991

nxënës/e



61%

Vajza të reja

Gjatë periudhës prill-qershor, organizatat partnere zbatuan 151 punëtori online përmes Zoom me 2,991 nxënës (39% M, 61% F) në Shqipëri, Kroaci, BiH, Kosovë dhe Serbi.

Në varësi të kontekstit, partnerët përgatitën punëtori dhe filluan të punojnë në mjedisin online, në një mënyrë entuziaste dhe të përkushtuar. Për disa prej tyre, përdorimi i platformave online dhe shpikja e qasjeve kreative për të motivuar të rinjtë ishte sfiduese në fillim, por ata arritën të arsimonin veten me ndihmën e bashkëmoshatarëve-kolegëve apo edhe të anëtarëve të klubeve ‘Bonu Burrë’.

Duke përdorur qasje, teknologji dhe platforma inovative, partnerët kanë arritur të ulin stresin dhe të mbështesin përfituesit e tyre në këto rrethana të ndryshuara. Punëtoritë e YMI vazhduan shpejt rrjedhën e tyre në “normalitetin e ri” të induktuar nga COVID-19 dhe demonstuan reziliencën e tyre ndaj krizës dhe ndryshimeve.

3.3. Podkast-et

Podkast-et janë një nga mënyrat më inovative për të ofruar përmbajtje informative, kreative dhe të dobishme dhe për të arritur një audiencë. Kjo ishte logjika prapa podkast-ëve që u përdorën si pjesë e adaptimeve COVID-19 të YMI-së. Podkast-et u shfaqën si një zgjidhje e përshtatshme për të përballuar mbylljen dhe stresin e shkaktuar. Duke marrë parasysh që gjithçka zhvillohet online, ekipet e YMI e dinin që përmbajtja e tyre duhej të ishte unike dhe e veçantë. Kriteret për relevancën e podkast-it ishin mjaft të rrepta - duhej të adresonte nevojat e veçanta të të rinjve/rejave gjatë pandemisë pa pandeminë në fokus; duhej të ishte dëfryes, i bazuar në YMI, informativ dhe, më e rëndësishmja, duhej të ishte autentik për të arritur grupin tonë të synuar.

Idėja ishte të largonte mendjen e audiencës së YMI nga çfarë po ndodh dhe t'i siguronte ata se jeta do të vazhdojë, pavarësisht izolimit, duke ia rikujtuar atyre vendet e tyre të lumtura dhe muzikën e preferuar dhe duke sjell kështu gëzim dhe qetësi gjatë këtyre kohërave të vështira.



29

podcast-e



5.353

të rinj/reja



200.000

përdorues përmes mediave sociale

Gjatë periudhës prill-korrik, partnerët prodhuan 29 podcast-e që u dëgjuan nga 5,353 të rinj/reja dhe arritën më shumë se 200,000 përdorues përmes mediave sociale.

Në Beograd, Qendra E8 kishte zhvilluar podkast-in e saj RINIA në fillim të prillit, dy javë pas prezantimit të mbylljes zyrtare dhe masave të gjendjes së jashtëzakonshme. Anëtarët e stafit dëshironin të ofronin një mekanizëm të dobishëm përballimi, të krijonin përmbajtje edukative të dizajnuar për të rinjtë, që do t'i angazhojë ata në mbështetjen e lëvizjes YMI, për mënyrat e shëndosha të jetesës, parandalimin e dhunës dhe barazinë gjinore. Podkast-et eventualisht kishin arritur një audiencë edhe më të gjerë. Të ftuarit e podkast-eve u shënjuan si 'superheronj' d.m.th modele për t'u marrë shembull nga të rinjtë - aktivistë, gazetarë, artistë dhe idolë të të rinjve nga Serbia ose rajoni. Atyre iu kërkua të zgjedhin një imazh të veçantë që përfaqëson vendin e tyre të të preferuar ku ndihen të lumtur dhe të luajnë muzikën e tyre të preferuar në shfaqje.

Podkast-i 'Patëllxhanët me Pizhame' (Eggplants in Pajamas) u zhvillua dhe prodhua në Kroaci si një hapësirë për një seri diskutimesh dëfryese dhe të singerta rreth çështjeve që kanë peshë për të rinjtë/rejat në këto kohë krize. Vullnetarët e rinj të Statusit M identifikojnë shpejt tema në lidhje me barazinë gjinore, shëndetin mendor, dhunën dhe çështje të tjera që ndikojnë në jetën e të rinjve/rejat gjatë mbylljes. Atyre u bashkohen ekspertë të cilët ofrojnë pikëpamje dhe këshilla interesante në lidhje me çështje të tilla si distancimi shoqëror, pornografia, ndarja e drejtë e punës së kujdesit ose rritja e dhunës në familje.

Partnerët e YMI prodhuan podkast-e gjatë mbylljes dhe gjendjes emergjente që kanë një potencial të jashtëzakonshëm për të tejkaluar rrethanat në të cilat ishin krijuar. Për më tepër, ata do të vazhdojnë me prodhimin e podkast-eve në të ardhmen. Podkast-et përmirësuan vizibilitetin e aktiviteteve të YMI, krijuan lidhje me akterë të tjerë në skenën publike, demonstruan relevancën dhe aftësitë përshtatëse të partnerëve të YMI dhe sollën një dimension të ri 'taze' në projekt. Në fund, prodhimi i podkast-eve ndihmoi partnerët të fitojnë dhe të përmirësojnë shkathhtësitë teknike të nevojshme për botën online në të cilën po jetojmë aktualisht.

3.4. Sfidat e mediave sociale, kuizet dhe gjëegjëzat

Për të mbajtur aktiv përfituesit/et e rinj/reja, të gjitha organizatat partnere planifikuan aktivitete online për rininë për të ofruar përmbajtje edukative online në një mënyrë argëtuese. Të gjithë partnerët eksploruan aplikacione dhe rrjete sociale shitesë që mund të përdoren për të ofruar përmbajtje online në lidhje me promovimin e barazisë gjinore, mosdhunës dhe mënyrave të shëndosha të jetesës.

Në periudhën mars-korrik, të gjitha organizatat partnere përdorën histori/storje Instagram-i dhe Facebook-u, aplikacione të tjera si Mentimeter, Kahoot!, Chatbot, si dhe kanale Youtube, dhe realizuan 17 kuize dhe lojëra të ngjashme në të cilat 4,813 përfitues morën pjesë drejtpërdrejt dhe mbi 500,000 u arritën përmes mediave sociale.

SMART kolektiv, një organizatë partnere nga Beogradi e angazhuar për zhvillimin e fushatës YMI, përshtati materialin e fushatës 'A je OK?' ndaj COVID-19. Një nga aktivitetet e përbashkëta rajonale të YMI ishte sfida e Instagram e kujtimeve të #KBB, ku anëtarët e KBB postuan fotot e tyre nga aktivitetet e mëparshme të YMI në Instagram.

Në Kosovë, KKLubi 'Bonu Burrë' organizoi një kuiz përmes platformës Kahoot! për të diskutuar gjuhën e urrejtjes si një nxitës i ekstremizmit dhe dhunës rinore. Kuiz-i u bazua në fushatën e YMI-t 'NDEZ dijen, NDAL urrejtjen' kundër ekstremizmit dhe dhunës dhe përfshinte 10 pyetje. Dhjetëra anëtarë të KBB morën pjesë online përmes platformave Zoom dhe Kahoot! dhe tre anëtarë të KBB me më së shumti pikë fituan si çmim libra në lidhje me mendimin pozitiv, bisedën e hapur dhe zgjidhjen paqësore të konfliktit.

Qendra E8 ka dizajnuar kuizin online 'pëllumbi Mirko dhe & pëllumbesha Marina' lidhur me fushatën 'DHEZI njohuritë, FIKE urrejtjen' kundër radikalizimit dhe dhunës në mesin e të rinjve. Kuizi filloi më 25 maj, duke përdorur platformën Manybot të lidhur me Facebook Messenger dhe përfshinte 10 pyetje të pasuara nga një shpjegim dhe një përmbajtje edukative. Kuizi zgjati për dhjetë ditë rresht dhe u përfundua nga 600 të rinj nga Serbia dhe rajoni. Pëllumbi Mirko dhe pëllumbesha Marina shpërblyen pjesëmarrësit duke zgjedhur në mënyrë rastësore dhjetë persona çdo ditë në Instagram live, të cilët më pas morën materiale promovuese të YMI si çanta shpine, kapela dhe kufje. Kuizi dhe historitë live në Instagram fituan shumë publicitet dhe mbi 200,000 njerëz u arritën përmes rrjeteve sociale.

Perpetuum Mobile së bashku me anëtarët e KBB krijuan dy Instagram sfida për të mbetur në kontakt me të rinjtë/rejat. Në mars, sfida ishte që të rinjtë të nominonin bashkëmoshatarët e tyre për të rekomanduar një libër dhe një film për ta shikuar gjersa janë në izolim, dhe për të shkruar një përshkrim të shkurtër mbi atë se për çfarë bënte fjalë libri dhe filmi. Në të njëjtën kohë, ata përhapën mesazhin #RrIN'shpi, për t'ia bërë me dije të rinjve/rejave se është e nevojshme të ndjekin rregullat në situatën e tyre aktuale dhe të rrinë në shtëpi - por jo të vetëm! Sfida e prillit u fokusua në kuize, gjëgjëza dhe fjalëkryqe që u postuan në Instagram Story për të folur rreth mënyrave të shëndosha të jetesës. Për më tepër, ata zhvilluan një fotokornizë në Facebook, si dhe afishe (stikerë) Viber dhe Whatsapp për të përhapur mesazhet e projektit YMI.

3.5. Ngjarjet online

Të gjitha organizatat partnere përmendën ngjarjet online si një nga përshtatjet kryesore ndaj pandemisë COVID-19. Për të bashkëvepruar me përfituesit, ata i kaluan ngjarjet e planifikuara në modalitetin online, kryesisht duke përdorur Zoom ose platforma të ngjashme. Kjo nuk ishte një risi për projektin, pasi partnerët e YMI mbanin takime online çdo muaj dhe janë pjesë e rrjeteve evropiane dhe globale që mbështeten në takime online. Partnerët u përshtatën shpejt dhe sfida kryesore ishte angazhimi i mësuesve dhe palëve të interesuara institucionale për të marrë pjesë, pasi ata ishin të ngarkuar me konfigurimin e shkollimit online dhe aktivitete të tjera të ngjashme

gjatë mbylljes totale. Gjatë periudhës mars-korrik, partnerët morën pjesë dhe organizuan 248 takime online nga të cilat 36 ishin në formën e konferencave online ose uebinarëve që mbledhën 12,511 pjesëmarrës/e.

Si reagim ndaj pandemisë COVID-19, më 30 qershor 2020, Qendra E8 organizoi një konferencë globale 24-orëshe MAN2020, kushtuar ndërtimit të lëvizjes YMI. Këtë vit, konferenca MAN festoi dhjetëvjetorin e saj dhe mbledhi së bashku ekspertë dhe praktikues nga e gjithë bota. Programi përbëhej nga uebinarë në internet, fjalime kryesore, performanca audio-vizuale, shfaqje virtuale dhe filmash, si dhe realizime grafitesh në lidhje me barazinë gjinore dhe maskulinitetin. Këtë vit, 4,121 njerëz nga e gjithë bota morën pjesë si audiencë në një ose disa panele.

Me debate online për mënyra të shëndosha të jetesës gjatë karantinës!

Në Banja Llukë, Perpetuum Mobile lansoi debate online me nxënës/e të shkollave të mesme të Banja Llukës për t'iu mundësuar atyre të shprehin pikëpamjet e tyre, për të ushqyer një kulturë dialogu dhe komunikimi jo të dhunshëm, si dhe për të gjetur zgjidhje për çështjet dhe problemet e identifikuara të të rinjve/rejave. Temat kryesore të debatit rridhnin nga Programi Y dhe përfshinin si këtu më poshtë:

- Kujdesi shëndetësor publik është më i mirë se kujdesi privat;
- Shqetësimi emocional i një burri çon në perceptimin e tij negativ në shoqëri;
- Media është përgjegjëse për ç'rregullimet e të ushqyerit të të rinjve/rejave;
- Të gjithë njerëzit duhet të jenë vegjetarianë;
- Dhuna është më e shpeshtë në zonat e varfra.

Joga për të pastruar mendjen dhe trupin!

SIT dhe YMCA nga Kosova organizuan ushtrime online të joga-s për 529 pjesëmarrës nga Kosova dhe rajoni me mësues profesionistë dhe instruktorë të joga-s, si përgjigje ndaj nivelit të ulët të aktiviteteve fizike të të rinjve gjatë karantinës. Sesionet e joga-s ishin ngjarje shumë të popullarizuara dhe frymëzuese që mbledhën jo vetëm anëtarët e KBB dhe përfitues të tjerë të rregullt, por angazhuan edhe pjesëmarrës të tjerë që ndoshta nuk do të arriheshin nëpërmjet ngjarjeve të rregullta në qytetet e synuara.

“Chat Room” - një shfaqje live nga klubi ‘Bonu Burrë’ dhe Real Girls (Qikat e Përnjimendëta) Sarajeva

Shfaqja u sjau nga anëtarët e KBB nga Shoqata XY për të siguruar përmbajtje dëfryese dhe edukative për të rinjtë/rejat në Instagram. Çdo të premte duke filluar në ora 19:00, Chat Room transmetoi, pasi nikoqiri i KBB të kish shtruar muhabetin e lirë me të ftuarit e tij, modelet shembull nga komuniteti lokal, duke diskutuar trendet aktuale të të rinjve dhe duke ofruar perspektiva inovative për të promovuar barazinë gjinore, mënyrat e shëndosha të jetesës dhe mosdhunën gjatë pandemisë.

3.6. Prodhimi i video materialeve për të angazhuar të rinjtë/rejat

Të rinjtë dhe të rejtat përdorin video dhe media sociale gjatë gjithë kohës, dhe meqenëse rinia është forca shtytëse për ndryshimin në YMI, është në interesin më të mirë të YMI të ketë gjithashtu një prani online. YMI me partnerët e saj dhe KBB kanë mjete të ndryshme komunikimi për të arritur rininë në të gjithë Ballkanin. Nëpërmjet video materialeve të prodhuara, është shumë më e lehtë të arrihet një numër më i madh i tyre, duke ndjekur idenë e CARE / YMI se asnjë i ri/e re nuk duhet lënë pas. Krijimi i video-ve është një aktivitet i rregullt i YMI dhe qendra video të ndryshme janë prodhuar gjatë viteve. Sidoqoftë, që kur filloi pandemia COVID-19, partnerët kanë bërë më shumë përpjekje në prodhimin e videove me të rinj/reja që janë shembull për bashkëmoshatarët e tyre, për të mbështetur të rinjtë/rejat në karantinë.

Gjatë gjithë periudhës, YMI ka prodhuar një mori të videove që trajtojnë tema sociale si parandalimi i dhunës me bazë gjinore dhe të gjitha llojet e dhunës, ekstremizmi dhe radikalizimi, puna e të rinjve dhe të ngjashme, dhe secila video ka një mesazh që shënjestron jo vetëm të rinjtë, por edhe komunitetin në tërësi. Gjatë COVID-19, prodhimi i videove është mjeti kulminant që YMI të përcjellë mesazhe tek të rinjtë/rejat, në mënyrë që ata/o të qëndrojnë pozitivë gjatë izolimit, dhe gjithashtu një mjet për të ofruar rekomandime se si të përballen me situatën. Disa nga videot e prodhuara përfshijnë video për YMI, Shëndeti mendor dhe COVID-19, 7 podkaste KBB dhe 7 video edukative të Programit Y prodhuar nga PM, ide kreative nga anëtarët e KBB në Tiranë në izolim, 24 video nga Qendra E8 lidhur me përvojën online nga punëtoritë e Programit Y, video motivuese nga anëtarët e KBB, shënimi i Dita e Miqësisë dhe Dita e Shkathësive Rinore në Prishtinë, dhe shumë të tjera.

Programi Y video edukuese për rrjetet sociale

Në Mostar, anëtarët e KBB të Youth Power krijuan 12 video edukative me 12 tema nga Programi Y. Qëllimi i videove është të edukojë rininë për barazinë gjinore, mënyrat e shëndosha të jetesës dhe pa dhunë, dhe të nënvizojnë mesazhet kryesore të punëtorive edukative. Videot edukative u zhvilluan në formën e skicave, 'shkarravitjeve', secila me kohëzgjatje nga 1 deri në 2 minuta. Video narratorët ishin edukatorë bashkëmoshatarë që vinin nga shkollat e mesme të shënjestruara dhe anëtarët e KBB Mostar të cilët shprehën dëshirën e tyre për të marrë pjesë në zhvillimin e këtyre videove.

Videot tregohen në gjuhën lokale, me titra në anglisht dhe postohen në Youth Power dhe në faqet e Facebook KBB dhe Instagram.

3.7. Mbështetja psikologjike

Pasiguria e shkaktuar nga pandemia e koronavirusit ka pasur një ndikim të fortë në shëndetin mendor, i cili ka një rëndësi të madhe për adoleshentët dhe transformimin e tyre nga fëmijëria në moshën e rritur. Shëndeti mendor ishte një nga temat kryesore të programimit YMI dhe të gjitha

organizatat partnere bënë përpjekje shtesë për të përmbushur nevojat e anëtarëve të KBB, të rinjve të shëmbjestruar dhe komuniteteve.

Në të gjithë rajonin, të gjitha KBB-të ofruan udhëzime dhe mbështetje të bashkëmoshatarëve në trajtimin e krizës, duke mbajtur seanca të joga-s, seanca online me psikologë dhe duke prezantuar seanca këshillimi online në disa vende. Për më tepër, organizatat partnere Shoqata XY dhe SIT zgjeruan aktivitetet e tyre të rregullta në lidhje me mbështetjen psikosociale për të rinjtë/rejat dhe prindërit që nga marsi i vitit 2020 dhe krijuan linja shtesë telefonike, angazhuan ekspertë psikologë dhe u përqendruan më shumë në shëndetin mendor të përfituesve.

1,314 të rinj dhe të rritur kanë marrë mbështetje kolegjiale ose profesionale gjatë periudhës mars-maj direkt nga organizatat partnere.

Ne nuk jemi vetëm!

Anëtari i KBB Mostar organizoi punëtori për shëndetin mendor me psikologë dhe krijoi një grup grafikësh mbi ruajtjen dhe kujdesin për shëndetin mendor gjatë pandemisë së koronavirusit dhe izolimit në shtëpi. 20 këshilla të paraqitura në formën e pesë grafikëve dhe një artikull janë krijuar dhe shpërndarë në mediat sociale. Mesazhet kryesore të shpërndara brenda fushatës ishin: Ne nuk jemi vetëm! Nuk jemi as të pazotë, përveç nëse zgjedhim të jemi të pazotë sepse, çfarëdo që të na gjejë, ne kemi mundësinë të dalim nga ajo situatë.


Organizata partnere në SIT e Kosovës i ka dhënë rëndësi të madhe shëndetit mendor dhe ofrimit të shërbimeve për të ndihmuar të rinjtë/rejat në nevojë. Duke marrë parasysh përvojën e tyre në dhënien e mbështetjes psikosociale, duke përfshirë ekspertët e brendshëm, ata kanë krijuar një linjë telefonike për të ndihmuar njerëzit që kalojnë periudha të vështira dhe / ose përjetojnë dhunë. Ka linja telefonike dhe seanca këshillimi online me dy psikologë dhe rreth 20 përfitues të rregullt kanë kërkuar ndihmë. Ata kanë përdorur të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion (rrjetet sociale, Whatsapp, Viber, Messenger, si dhe thirrjet telefonike dhe postat elektronike). Disa nga çështjet e tyre kryesore janë: parandalimi i hidhërimit, përballimi i vetmisë, përballimi i karantinës dhe mungesa e shkollës së rregullt dhe mjedisit të punës.

Këshilltar prindëror në kohën e koronavirusit

Gjatë tre viteve të fundit, Shoqata XY ka zbatuar me sukses “Këshilltarin Prindëror XY” për të siguruar informacion dhe mbështetje për prindërit e adoleshentëve dhe fëmijëve të të gjitha moshave përmes platformave digjitale. Në fillim të shpërthimit të COVID-19, aktivitetet brenda Këshilltarit Prindëror dolën në pah dhe platforma filloi të ofrojë këshilla duke theksuar ruajtjen e shëndetit mendor gjatë mbylljes, organizimi dhe gjetja e mënyrave për të përmbushur detyrimet, por edhe zgjidhje krijuese për fëmijët, adoleshentët dhe prindërit në lidhje me të mësuarit dhe kohën e lirë. Për më tepër, shërbimet e këshillimit psikosocial të Shoqatës XY ishin të arritshme online për të rinjtë dhe prindërit e tyre, të cilat u promovuan gjatë dhe pas fushatës.

3.8. Vlerësimi përmbyllës

Vlerësimi përmbyllës i zbatimit të Programit Y në shkollat e synuara ishte planifikuar të kryhej në fund të vitit shkollor 2019/2020 në shkollat e mesme me anë të metodës laps-e-letër. Sidoqoftë, mbyllja e COVID-19 ka sfiduar CARE dhe partnerët për të gjetur mjete të reja zbatimi. Drejtorët/et e shkollave, mësimmhënësit/et dhe personeli tjetër shkollor kanë qenë shumë të përkushtuar dhe kanë punuar së bashku me CARE dhe organizatat partnere për të gjetur zgjidhje në internet dhe për të angazhuar nxënësit/et për të plotësuar pyetësorët. Me disa vonesa, vlerësimi përmbyllës u krye me sukses në të gjitha shkollat e synuara duke përdorur një formë google të pyetësorëve, klasat e Google dhe platforma të tjera të përdorura nga shkollat.



Vlerësimi përmbyllës shqyrtoi efektet e aktiviteteve të projektit mbi pikëpamjet në lidhje me marrëdhëniet gjinore; shëndeti i të rinjve dhe grave, duke përfshirë shëndetin mendor; përdorimi i substancave psikoaktive; njohuri në lidhje me shëndetin riprodhues seksual; përvojën e të rinjve që kanë pësuar dhe ushtruar dhunë. ***INë hulumtimin përmbyllës, 1,895 pjesëmarrës (853 burra të rinj dhe 1,042 gra të reja) nga të gjitha shkollat e synuara të projektit ku kishte ndërhyrje plotësuan anketën.***

Në hulumtimin përmbyllës, numri i të anketuarve ishte 40% më i ulët për shkak të pandemisë që rezultoi në mbylljen e shkollave, ku të paktën 20% e studentëve nuk kishin qasje në internet.

Rekomandimet dhe gjetjet e vlerësimit përmbyllës treguan rezultate pozitive të ndërhyrjes së projektit dhe kontributeve të CARE dhe partnerëve në ndryshimin e mjedisit shkollor dhe edukimin e gjeneratave të reja të të rinjve në Ballkan për mënyrat e shëndosha të jetesës, respektimin e barazisë gjinore dhe sjelljen më pak të dhunshme, gjë që na inkurajon të vazhdojmë me këto përpjekje, edhe gjatë pandemisë së koronavirusit.

3.9. Fushatat e Normave Sociale dhe COVID-19

Fushatat e mediave sociale nuk janë një risi në projektin YMI - çdo partner harton mënyrën e tij të zbatimit të një aktiviteti dhe çdo partner ndjek udhëzimet rajonale të fushatës YMI duke i përshtatur ato me kontekstin specifik. Përdorimi i mjeteve dhe platformave të mediave sociale ka qenë i pranishëm që nga fillimi i projektit, por në këto rrethana të veçanta, partnerët kishin një detyrë më serioze - të përshtatnin fushatat e tyre me situatën COVID-19, për të mbetur të përditësuar dhe relevante, dhe natyrisht, për të vazhduar me të gjitha aktivitetet e rëndësishme.

Gjatë pandemisë, kur të gjithë filluan të punojnë dhe zbatojnë aktivitete online, partnerët pothuajse menjëherë zunë hapin, duke ndarë fushatat në mënyrë tematike në kategori të ndryshme:



Fushatat e ndërlidhura me COVID-19 të përdorura me qëllim të promovimit të masave të sigurisë dhe shëndetit fizik. Këto lloj aktiviteteesh përdorën platforma të mediave sociale si Instagram, Twitter dhe Facebook në mënyrë që të japin mesazhe të rëndësishme për larjen e duarve, mbajtjen e distancës dhe mbajtjen e maskave të fytyrës. Youth Power nga Mostari, AfS nga Tirana, YMCA së bashku me SIT nga Kosova promovuan masat e sigurisë me fotot e vullnetarëve të tyre të veshur me PMP.

Programi Y - Fushatat e përshtatura për COVID 19 u krijuan nga përmbajtja ekzistuese e Programit Y e cila ishte qëndisur për t'iu përgjigjur krizës COVID-19. Këto fushata u zbatuan nga Shoqata XY nga Sarajeva, Klubi “Bonu Burrë” nga Sarajeva, Perpetuum Mobile nga Banja Luka, Youth Power nga Mostari dhe Status M me krijimin e kartave edukative që dekonstruktojnë rolet gjinore dhe pritjet në krizë.



Fushatat sociale të dizajnuara për të kujtuar publikun në lidhje me **rastet e rritura të dhunës**, për shkak të izolimit afatgjatë, mbylljeve dhe niveleve më të larta të stresit. Këto lloj fushatash u zbatuan nga Shoqata XY në Sarajevë, AFS nga Tirana dhe SIT nga Prishtina, duke adresuar problemet e abuzimit në familje dhe sigurinë e grave dhe vajzave gjatë pandemisë.



Fushatat e ndërlidhura me shëndetin mendor u dizajnuan për të theksuar rëndësinë e shëndetit mendor në një kohë kur shqetësimi më i madh i të gjithëve është shëndeti fizik. Promovimi i mënyrave të shëndosha të jetesës ishte gjithashtu një pjesë e madhe e këtyre fushatave, të cilat shërbyen si një kujtesë se abuzimi me alkoolin dhe substancat nuk do të sjellin hare dhe çlirim nga stresi. Qasjet inovative erdhën nga Klubi Bonu Burrë në Sarajevë, Youth Power, Qendra E8 dhe Perpetuum Mobile.



Partnerët ndanë video materiale, animacione, fotografi dhe udhëzime përmes mediave sociale, se si të mbrojnë veten dhe të tjerët, si dhe vendet e rëndësishme për të kërkuar ndihmë dhe asistencë. Kjo lloj përmbajtjeje u përdor për ngritjen e vetëdijes për tema të rëndësishme që mund të ishin lënë pas dore gjatë gjendjes emergjente. Mediat sociale kanë një ndikim të madh të rinjtë/rejat, kështu që partnerët e YMI-së rritën praninë e online për të përhapur mesazhet e rëndësishme.



Askush nuk është vetëm, edhe në këto kohë të jashtëzakonshme dhe konfuze.

Stresi dhe izolimi nuk janë një justifikim

për dhunë, dhe në fund - Shëndeti mendor është

po aq i rëndësishëm sa shëndeti fizik.

Gjatë periudhës mars-korrik, partnerët organizuan 57 fushata në internet që angazhuan drejtpërdrejt **41,543 pjesëmarrës**. Nga ky numër, **8145** njerëz u angazhuan në fushata enkas të qëndisura të krijuara nga partnerët për të dërguar mesazhe të forta në lidhje me #RriN'shpi dhe masat parandaluese të COVID-19, dhe krijuan materiale promovuese të tilla si maska.

Pandemia COVID-19 ka motivuar CARE dhe partnerët të përdorin të gjitha fushatat e mëparshme dhe t'i përshtatin ato me situatën aktuale, kështu që të gjithë partnerët përdorën fushatat e mëparshme "A je OK?" dhe "Reago Njerëzishëm" për të diskutuar shëndetin mendor, pozicionin e të rinjve/rejave gjatë karantinës dhe për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore si dhe për të ndihmuar të rinjtë të përballen me krizën.

Nën koordinimin e SMART Kolektiv, të gjithë partnerët kanë punuar së bashku për të gjetur mënyra për të mbështetur të rinjtë dhe komunitetet gjatë krizës. Për më tepër, fushatat e normave shoqërore ofruan një dritare mundësie për tu përshtatur me rrethanat aktuale të shkaktuara nga COVID-19 dhe për të arritur përfituesit e synuar. YMI ka përdorur fushatën më të fundit të zhvilluar "Ndez Dijen, Ndalo Urrejtjen" për të ndihmuar dhe mbështetur të rinjtë/rejat në vetëizolim gjatë kësaj kohe të krizës globale. Ideja kryesore prapa fushatës ishte promovimi i sjelljes prosociale mes të rinjve/rejave në shkollat e mesme (mosha 14-20 vjeç) duke vendosur shembuj të sjelljes së mirë dhe thyer stereotipet që shkaktajnë qëndrime dhe sjellje ekstreme, duke larguar kështu të rinjtë nga sjellja e rrezikshme ose ekstreme.



Konkludimet dhe mësimet e nxjerra



4. Konkludimet dhe mësimet e nxjerra

Përhapja e vazhdueshme e COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në aktivitetet e YMI, pasi që të gjitha vendet e shënjestruara të projektit ishin nën mbryllje të plotë gjatë periudhës mars-maj, dhe shumica e tyre aktualisht janë nën masat e sigurisë dhe parandalimit që përfshijnë orën policore të pjesshme, kufizimet e vogla të lëvizjes dhe lirive të tjera qytetare, duke përfshirë tubimet dhe ngjarjet shoqërore dhe kulturore. Meqenëse aktivitetet e projektit përqendrohen kryesisht në punën me të rinjtë në komunitete dhe institucione arsimore në të gjithë rajonin, kriza COVID-19 ka ndikuar ndjeshëm në zbatimin e projektit. YMI ka dëshmuar përsëri që qasja e saj është e përshtatshme dhe e adaptueshme ndaj kontekstit të dhënë. YMI u krijua për të rinjtë/rejat, për t'iu përgjigjur nevojave të tyre, kudo që të jenë ata/o. Siç është përmendur tashmë, megjithëse shpërthimi i COVID-19 ka ndikuar ndjeshëm në aktivitetet e projektit, ajo nuk i ndaloi ato. Përkundrazi, kjo i frymëzoi të rinjtë/rejat dhe partnerët të bëhen inovativë, të rimendojnë dhe të përdorin zgjidhje të krijuara nga të rinjtë/rejat në mënyrë që të krijojnë hapësira të sigurta për pjesëmarrësit tanë. Përvoja kolektive e YMI, e përfaqësuar në këtë rast studimi, çon në përfundimin se YMI është shumë reziliente ndaj krizës dhe e shtytur nga motoja e saj – të punojmë me të rinjtë dhe për rininë gjithë kohën. Këtu më poshtë janë mësimet kryesore të nxjerra që shpresojmë se mund të zbatohen në kontekste të tjera ose lloje të ngjashme krizash në të ardhmen:



Konkludimet:

- Digjitalizimi i aktiviteteve që u zhvilluan ishte një azhurnim dhe zgjerim i punës së mëparshme digjitale. Përshtatja e shpejtë u bë e mundur për shkak të mbështetjes dhe investimeve afatgjata të CARE në kapacitetet teknike dhe përpjekjet kreative të partnerëve.
- Të gjithë partnerët kanë krijuar marrëdhënie të qëndrueshme dhe të besueshme me palët kryesore të interesit, mbi të gjitha me të rinjtë/rejat si grupi i shënjestruar i projektit. Njohja dhe të kuptuarit e partnerëve e çështjeve kryesore u ka mundësuar atyre që t'i përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave të të rinjve duke prezantuar aktivitete inovative online që kanë dëshmuar se janë jashtëzakonisht të suksesshme.
- Pritjet ishin të ulta, por CARE dhe partnerët kanë hyrë me guxim në territorin e paeksploruar për sa i përket testimit të qasjeve që funksionojnë më mirë, të cilat kërkonin një nivel të lartë fleksibiliteti dhe “të menduarit ecazi”.



Mësimet e nxjerra: Bota Online

- Komunikimi dhe fleksibiliteti i vazhdueshëm midis CARE dhe partnerëve sollën hapësirë për inovacion përmes një qasjeje pjesëmarrëse.
- Punëtoritë online dhe aktivitetet e tjera nuk mund të shihen si zgjidhje afatgjata kur bëhet fjalë për ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të të rinjve/rejave përmes metodologjisë YMI,

por më tepër si një shtesë e suksesshme ndaj punës në terren në mjedisin shkollor. Udhëzime të reja sistematike duhet të zhvillohen për mënyrat online të punës me të rinjtë/rejat.

- Kryerja e vlerësimeve online duhet të konsiderohet si një zgjidhje dytësore, pasi nuk ka prova që kjo mund të zëvendësojë plotësisht vlerësimet në terren.
- Mjetet online të komunikimit kursejnë kostot e organizimit të ngjarjeve në terren dhe mundësojnë arritjen e më shumë pjesëmarrësve nga komunitete dhe vende të ndryshme.
- Barra më e madhe e adaptimit online u bart nga stafi i projektit YMI dhe anëtarët e KBB për sa i përket adaptimit, krijimit të përmbajtjes dhe zbatimit, e cila duhet të merret parasysh në planifikimin dhe buxhetimin e ardhshëm.
- Pas çdo zbatimi intensiv të aktiviteteve online, që zgjat 3-4 javë, mund të ndihet një ngopje në mesin e përfituesve, si dhe stafi që zbaton projektin, kështu që duhet planifikuar me kujdes, në mënyrë që të shmangët rreziku i harxhimit dhe rraskapitjes së përgjithshme. Intensiteti i njëjtë nuk është diçka që duhet pritur rregullisht.
- Aktivitetet online sollën prezencë më të madhe online dhe vizibilitet të projektit dhe aktiviteteve të partnerëve.



Mësimet e nxjerra: Konteksti dhe Kapacitetet Institucionale

- Në krizë, institucionet tentojnë të mbyllën edhe më shumë dhe të përqendrohen vetëm në prioritetet kryesore që ndikojnë në planet e përgjithshme të zbatimit të projektit; Modelet ekzistuese për punën në shkolla nuk janë përshtatur për përdorim online dhe implementimi ishte i suksesshëm ku drejtorët e shkollës, mësuesit dhe ministritë shfrytëzuan mundësinë për inovacion gjatë krizës dhe prezantuan modele të punës të drejtuara nga të rinjtë/rejat.
- Përveç udhëzimeve të mikroorganizimit të punëtorive, fletëpalosjet dhe teknikat e mësimdhënies nuk janë në përputhje me formatin e ri të shkollimit, e cila është diçka për t'u shqyrtuar në të ardhmen.
- Është e nevojshme që të rinjve t'u jepet më shumë hapësirë dhe mundësi për të shprehur kreativitetin dhe idetë e tyre dhe t'i konsiderojnë ata si akterë kryesorë në zhvillimin e mjeteve të reja online dhe zgjidhjeve digjitale.
- Arritja e të rinjve/rejave në qendrat e të miturve dhe të rinjve/rejave me status më të ulët ekonomik që nuk kishin qasje në internet gjatë mbylljes ishte e pamundur, kështu që grupet e marginalizuara ishin edhe më të marginalizuara në krizë.



Organizatrat partnere të YMI dëshmuar të jenë partnerë të besueshëm të sistemeve arsimore dhe stafi të shkollave ku ata ofruan ekspertizën e tyre dhe ndihmuar mësuesit të përgjigjen në mënyrë efikase ndaj nevojave të të rinjve gjatë pandemisë së koronavirusit.



Organizatrat partnere



Qendra VEPRO për SHOQËRINË

Tiranë, Shqipëri

www.actforsocietycenter.org



Shoqata XY

Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë

www.asocijacijaxy.org



Qendra E8

Beograd, Serbi

www.e8.org.rs



Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime - SIT

Prishtina, Kosovo*

www.sit-ks.org



YMCA në Kosovë

Prishtinë, Kosovë

www.ymcacosovo.com



Perpetuum Mobile

Banjallukë, Bosnje dhe Hercegovinë

www.pm.rs.ba



SMART Kolektiv

Beograd, Serbi

smartkolektiv.org



Status M

Zagreb, Kroaci

www.status-m.hr



Fuqia e të Rinjve (Youth Power)

Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë

eng.youth-power.org



Klubi Edukativ Rinor - Sinergjia

Mitrovicën Kosovën e Veriut

www.oek-sinergija.org

Kontaktoni:

 www.youngmeninitiative.net

Zyrat Ndërkombëtare të CARE në Ballkan:

 Hasana Kaimije 11
71000 Sarajevë
Bosnjë dhe Hercegovinë

 +387 33 536 790

 care@care.ba

 Aleja Svetog Save 7a
78000 Banja Lukë
Bosnjë dhe Hercegovinë

 +387 51 258 200

 spetkovic@care.ba

 Kneza Visislava 88
11000 Beograd
Serbi

 +381 11 7706 696

 emilenkovic@care.rs

 Gazmend Zajmi 21
10 000 Prishtinë
Kosovë

 +381 (0) 38 224 779; 222 435

 care.kosovo@care.org




With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

The OAK Foundation logo features a circular icon with a stylized oak leaf design to the left of the words "OAK" in a large, serif font, with "FOUNDATION" in a smaller, sans-serif font below it.



Reagimi digjital ndaj COVID-19



With funding from
= Austrian
Development
Cooperation

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

 OAK
FOUNDATION

 Young
Men
Initiative